



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 227, Datë 26.10.2018

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENER TRADE” SHPK, NË VEPRIMTARINË E
FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE.

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “ç” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, si dhe në zbatim të nenit 4, pika 1, gërma “d”, nenit 5, pika 1 gërma “d”, nenit 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, Nr. 109, datë 29.06.2016 dhe nenit 15 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.10.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për licencimin e shoqërisë “ENER TRADE” shpk, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 628 datë 03.10.2018, shoqëria “ENER TRADE” shpk, ka paraqitur kërkesën për tu pajisur me licencë në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Bordi i ERE-s me Vendimin nr. 221, datë 11.10.2018, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “ENER TRADE” shpk, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike për një afat 5 vjeçar.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje u publikua në media njoftimi me nr. 55/61 Prot, datë 11.10.2018. Po ashtu me shkresën nr. 628/2 Prot, datë 16.10.2018, iu kërkuar subjektit plotësimi i dokumentacionit të munguar që kishte të bënte me nenin 9, pika 2, gërma “d” (vërtetimi nga prokuroria dhe gjykata), për shoqërinë “ENER TRADE” shpk.
- Subjekti me shkresën nr. 628/1 Prot, datë 15.10.2018, ka paraqitur në ERE dokumentacionin e munguar cituar më sipër.
- Aplikimi i shoqërisë “ENER TRADE” shpk, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) Plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2), Plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3), Plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin furnizimit të energjisë elektrike (neni 9 pika 4.7 dhe 4.7.1), Plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “ENER TRADE” shpk, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5(pesë) vjeçar.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

KRYETARI

PETRIT AHMETI